



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.210-2/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj, Kryesues, Kymete Kicaj dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me kërkesën për rishqyrtim Anr.210-4/2025, të parashtruar nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr.210/2025, i datës 29.01.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar kërkesa Anr.210-4/2025 e datës 31.01.2025, e parashtruar nga subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë,

II. Ndryshohet vendimit i PZAP-it A.nr.210/2025 i datës 29.01.2025, Refuzohet e pa bazuar ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) e parashtruar kundër Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Paneli me Vendimin Anr.210/2025 të datës 29.01.2025, e kishte miratuar ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të parashtruar kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me të cilin vendim i kishte shqiptuar dënim më gjobë në lartësi prej 4 000.00 (katërmijë) Euro, dhe ka detyruar Subjektin Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

PZAP-i, me datë; 31.01.2025, ka pranuar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Anr.210/2025, nga Subjekti Politik LDK, me të cilën pretendohet se prova e bashkëngjitur nuk është administruar në mënyrën me meritore dhe të duhur nga Paneli, sepse ajo qartësisht e sqaron që palestra ka qenë e dhënë në shfrytëzim për hapësira të jashtme e të brendshme, nga ora 10:00 e mëngjesit deri në ora 20:00 të mbrëmjes.

Hapësirat e brendshme janë shfrytëzuar duke u vendosur skena, karriget, materialet zgjedhore, zërimi e te tjera, gjithashtu edhe hapësirat e jashtme janë shfrytëzuar duke u vendosur po ashtu material zgjedhore — baner, poster të subjektit politik dhe te disa kandidatëve të Pejës dhe jo vetëm, e ne rastin konkret edhe te kandidatit për deputet z. Arben Gashi, pëlqim për vendosje te materialeve zgjedhore, është i përgjithshëm dhe vlen ndaj te gjithëve (erga omnes) sepse është dhënë për subjektin politik LDK, dhe te gjitha kandidatet qe i kane shfrytëzuar këto hapësira, përfshire edhe z. Gashi janë kandidatë te LDK-se dhe jo te ndonjë subjekti tjetër.

Për këtë rast kërkojnë që vendimi i PZAP te anulohet ne tërësi.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se kërkesa për rishqyrtim dhe anulimin e vendimit Anr.210/2025 e datës;29.01.2025, është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës përkatësisht kërkesa Anr.210-4/2025, e datës; 31.01.2025, për rishqyrtimin e vendimit, rrjedh se Subjekti Politik LDK ka bashkangjitur si provë pëlqimin për lejim nga Komuna e Pejës-Pallati i sporteve Karagc, qe palestra ka qenë e dhënë ne shfrytëzim për hapësirave të jashtme e të brendshme, nga ora 10:00 e mëngjesit deri ne ora 20:00 te mbrëmjes. Paneli, Pëlqimin e ofruar nga parashtruesi i kërkesës e konsideroi si provë të pranueshme, sepse i njëjti është lëshuar nga Organi Kompetent, në këtë rast Komuna e Pejës.

Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 118 paragrafi 4, përcakton se, *“Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.*

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që kërkesën për rishqyrtim të aprovoj si të bazuar në kuptim të nenit 118 paragrafin 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.210-2/2025, datë 07.02.2025



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.